



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE
SEKTORI I AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

RAPORTI VJETOR I AKREDITIMIT

Tiranë, 2025

Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) është person juridik publik, përgjegjës për garantimin dhe sigurimin e cilësisë në Institucionet Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional, duke përdorur mekanizmat dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë, si vetëvlerësimi dhe akreditimi. Ajo monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht cilësinë e institucioneve. AKAFPK mbështet IoAFP-të përgjatë rrugëtimit të tyre në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Në zbatim të urdhrat të Ministrit përgjegjës për AFP-në, si dhe në funksion të analizës së ecurisë së procesit të akreditimit, AKAFPK-ja harton raportin¹ vjetor në të cilin paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë dhe ecurinë e IoAFP-ve në lidhje me procesin e akreditimit.

AKAFPK

Adresa:

Rruga: "Mustafa Lleshi", Godina e Thesarit, kati i tretë, Tiranë, Shqipëri

Kontakt:

Tel/fax. +355 42237087

E-Mail: info.akafp@akafp.gov.al

Website: www.akafp.gov.al

¹ Ky raport është dokument zyrtar i AKAFPK-së dhe përmban informacione për të cilat ky institucion është përgjegjës. Në asnjë rast, nuk lejohet tjetërsimi apo keqpërdorimi i këtij informacioni për qëllime të tjera përveç informimit të publikut. Të interesuarit që kërkojnë të kenë këto informacione dhe t'i përdorin ato për qëllimet e tyre, janë të lutur që zyrtarisht të kontaktojnë AKAFPK.

TABELA E PËRMBAJTJES	
SHKURTIMET	4
PËRKUFIZIMET KRYESORE	5
PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	6
KAPITULLI I: SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN PROFESIONAL	7
1.1 HYRJE.....	7
1.2 AKAFPK: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....	7
1.3 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË AKAFPK	8
1.4 VLERËSUESIT E JASHTËM	9
KAPITULLI II: VEPRIMTARITË KRYESORE TË AKAFPK	9
2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESEVE TË VLERËSIMIT	9
2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL	9
2.3 AKTIVITETI FINANCIAR.....	12
2.4 MONITORIMI I IOAFP-VE TË AKREDITUARA	16
KAPITULLI III: SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE.....	20
3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE	20
3.2 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT	21
3.3 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE	22
KAPITULLI IV: VEPRIMTARI NË KUADËR TË BASHKËPUNIMEVE	23
KAPITULLI V: PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2026	24

SHKURTIMET

AFP	Arsim dhe formim profesional
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
BE	Bashkimi Evropian
GVJ	Grupi i vlerësimit të jashtëm
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
SC	Sigurimi i cilësisë
SD4E	Programi i UNDP në Shqipëri “Zhvillimi i Aftësive për Punësim”
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

PËRKUFIZIMET KRYESORE

1. **“Akreditimi”** është njohja formale nga institucioni akreditues, që konfirmon se një ofrues i AFP-së përmbush standardet dhe kriteret ligjore të cilësisë, të përcaktuara në këtë rregullore.
2. **“Aplikant”** është ofruesi i AFP-së që ka dorëzuar kërkesën për akreditim, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me këtë rregullore.
3. **“Burimet e informacionit”** janë dokumentet, evidencat, raportet, statistikatat dhe të dhënat e përdorura për të verifikuar plotësimin e kriterëve dhe standardeve të cilësisë në kuadër të procesit të akreditimit.
4. **“Cikli i cilësisë”** PZKV- planifiko–zbato–kontrollo–vepro.
5. **“Institucioni akreditues”** është AKAFPK-ja që ka përgjegjësinë për dhënien, rinovimin ose revokimin e certifikatës së akreditimit;
6. **“Koordinator i procesit të akreditimit”** është specialisti i AKAFPK-së, i cili përgjigjet për koordinimin dhe monitorimin e procedurës së akreditimit të një ofruesi të AFP-së, nga dorëzimi i kërkesës për akreditim deri në dhënien e vendimit të akreditimit.
7. **“Procesi i akreditimit”** është një procedurë e strukturuar nëpërmjet të cilës një ofrues i AFP-së aplikon, merr, mban statusin e akreditimit, riakreditohet dhe përfshin dorëzimin e aplikimit, shqyrtimin e dokumenteve, vetëvlerësimin, vlerësimin e jashtëm, marrjen e vendimit për akreditim ose mosakreditim, në përputhje me nivelin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.
8. **“Standardet e cilësisë”** janë kuadri i cilësisë, i cili siguron që institucionet ofruese të AFP-së, të cilat i përmbushin ato, ofrojnë arsim dhe formim profesional cilësor, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor, KSHK-në dhe nevojat e tregut të punës.
9. **“Vlerësues i jashtëm”** është një bashkëpunëtor i jashtëm, i trajnuar dhe i certifikuar nga AKAFPK-ja për të mbështetur realizimin e veprimtarive të vlerësimit të jashtëm në kuadër të procesit të akreditimit për ofruesit e AFP-së, në përputhje me standardet dhe kriteret e parashikuara në rregullore.
10. **“Vlefshmëria e akreditimit”** është periudha gjatë së cilës akreditimi i një ofruesi të AFP-së është aktiv dhe i vlefshëm dhe ofruesi konsiderohet se përmbush në mënyrë të vazhdueshme standardet dhe kriteret ligjore të cilësisë.

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Viti 2025 përfaqëson vitin e katërt të zbatimit të procesit të akreditimit për institucionet që ofrojnë arsim dhe formim profesional në Shqipëri. Gjatë këtij viti, gjashtë ofrues të AFP-së, publikë dhe jopublikë, aplikuan për akreditimin institucional referuar kualifikimeve profesionale që ofrojnë, në përputhje me KSHK-në.

Përmes një pune intensive dhe angazhimi të vazhdueshëm në rishikimin dhe përmirësimin e urdhrit përkatës, si dhe të instrumenteve mbështetëse për zbatimin e procesit të akreditimit, u bë e mundur që aplikimet për këtë vit të nisin me sukses, falë edhe bashkëpunimit dhe vullnetit të vetë institucioneve ofruese të AFP-së.

Zbatimi i urdhrit për akreditimin përfshin të gjitha institucionet zbatuese dhe ofruesit e AFP-së, publikë dhe jopublikë, që ofrojnë programe që çojnë në kualifikime profesionale të plota dhe/ose të pjesshme në nivelet 2–5 të KSHK-së, përfshirë edhe proceset e Njohjes së të Nxënitis të Mëparshëm si dhe kualifikimet në kuadër të të nxënitis gjatë gjithë jetës.

Institucionet ofruese të AFP-së dhe aktorët e përfshirë në këtë proces dëshmuar se akreditimi mbetet një sfidë e rëndësishme, që kërkon përkushtim të lartë dhe përmbushjen e një sërë standardesh e procedurash, të cilat tashmë janë integruar në praktikën e tyre të përditshme.

AKAFPK

KAPITULLI I: SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN PROFESIONAL

1.1 HYRJE

Hartimi dhe publikimi i “Raportit Vjetor të Akreditimit 2025” në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në kuadër të procesit të akreditimit kryhet në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore.

Raporti paraqet një përmbledhje analitike të veprimtarisë së AKAFPK-së për vitin 2025, sfidave dhe objektivave të reja që lindin në kuadër të përshtatjes dhe përmbushjes të kërkesave të tregut dhe standardeve evropiane në lidhje me cilësinë që IoAFP-të duhet të garantojnë në ofertat e tyre ndaj tregut.

1.2 AKAFPK: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

AKAFPK-ja është person juridik publik, buxhetor përgjegjës për ndjekjen, garantimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e formimin profesional. AKAFPK-ja, përmes mekanizmave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e institucioneve të arsimit të formimit profesional në rang kombëtar.

AKAFPK-ja është krijuar për herë të parë me Vendim nr. 273, datë 10.5.2006, “*Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional*” dhe më pas Vendim nr. 321, datë 21.04.2011 si Agjenci Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve. Me Vendim nr. 673, datë 16.10.2019 u krye ristrukturimi i organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Misioni i AKAFPK-së përqendrohet në garantimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri. Kjo agjenci ka për detyrë të organizojë punën për të siguruar një nivel të lartë cilësie në zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), në hartimin dhe rishikimin e Listës Kombëtare të Profesioneve, Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, si dhe të garantojë përputhjen e standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Ajo harton dhe rishikon kurrikulat kombëtare të arsimit dhe formimit profesional (AFP), materialet mbështetëse, programe të unifikuara për kurse afatshkurtër duke u siguruar që ato të jenë të përditësuara dhe në përputhje me nevojat e sektorëve ekonomikë.

Gjithashtu, AKAFPK organizon punën për të garantuar nivelin e kualifikimit të mësimdhënësve të AFP-së dhe zbatimin e këtyre standardeve dhe programeve kombëtare nga institucionet publike të AFP-së. Një tjetër funksion i rëndësishëm është vlerësimi i cilësisë dhe akreditimi i ofruesve të AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), si dhe akreditimi i qendrave të vlerësimit që zbatojnë procedurat e njohjes së të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal. Në veprimtarinë e AKAFPK-së përfshihet edhe procesi i monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së, i cili lidhet me sigurimin e ruajtjes së nivelit të

cilësisë së kërkuar në ofruesit publik dhe jo publik të akredituar dhe ka si qëllim të vlerësojë përputhshmërinë me standardet dhe kriteret e akreditimit, në vijimësi.

Vizioni i Agjencisë është krijimi i një sistemi të integruar dhe fleksibël të kualifikimeve profesionale në përputhje me ndryshimet ekonomike dhe sociale, me nevojat e tregut të punës, i cili mundëson zhvillimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukture.

Në veprimtarinë për përmbushjen e misionit të saj, Agjencia gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të cilat publikohen dhe bëhen transparente për aktorët në fushën e arsimit formimit profesional.

1.3 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË AKAFPK

Struktura organike e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në vitin 2025 është në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve"*. Agjencia është organizuar në dy drejtori dhe tre sektorë dhe numri i punonjësve aktualë është 31. Struktura organizative përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP, Sektori i Akreditimit të Ofruesve AFP, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve.

Baza ligjore e funksionimit të AKAFPK

Në Shqipëri procesi i akreditimit të ofruesve të AFP-së ka nisur në vitin 2022 dhe tashmë ka hyrë në vitin e tretë të tij. Më poshtë gjendet një listë e ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e AKAFPK-së:

- Ligji nr. 15/2017, datë 16.02.2017, i ndryshuar "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" i ndryshuar.
- Ligji nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM nr. 673 datë 16.10.2019 "Për Organizimin Dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare Të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve".
- Urdhëri nr.845 datë 3.7.2025 për miratimin e "Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional" Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
- Rregullorja e brendshme miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me nr. 24/1 prot., datë 17.02.2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve".

- Urdhri i brendshëm i AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.07.2025 me nr. 262 prot., “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm, në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”.

1.4 VLERËSUESIT E JASHTËM

Në ushtrimin e veprimtarisë funksionale në kuadër të vlerësimit të jashtëm të procesit të akreditimit, AKAFPK-ja angazhon vlerësues të jashtëm për vlerësimin e IoAFP-ve. Gjatë vitit 2021 dhe 2022 AKAFPK ka përditësuar dhe zgjeruar listën e vlerësuesve të jashtëm, bazuar në kualifikimet e tyre si dhe aftësinë për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

Deri në vitin 2025 AKAFPK ka pasur në dispozicion një bazë të dhënash me 47 vlerësues të jashtëm të fushave të ndryshme të cilët janë angazhuar sipas nevojave.

KAPITULLI II: VEPRIMTARITË KRYESORE TË AKAFPK

2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESIT TË VLERËSIMIT

AKAFPK, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me Ligjin nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Urdhrit nr. 845/2025 të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përgatit dhe përmirëson vazhdimisht, dokumentet dhe formatet e nevojshme për proceset e sigurimit të cilësisë.

2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

AKAFPK-ja, me mbështetjen e UNDP-së Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim”, rishikoi urdhrin ekzistues nr. 128 datë 6.7.2021 “Për miratimin e “Rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”, në linjë me zhvillimet e prezantuara apo zbatuara në sistemin e ofertës së AFP-së. Draft urdhri synoi rregullime më gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme me nevojat e individëve dhe mobilitetit të shtuar të fuqisë punëtore me fokus Njohjen e të Nxënës të Mëparshëm dhe përfshirjen e kualifikimeve të të nxënës gjatë gjithë jetës në proceset e sigurimit të cilësisë.

Gjatë vitit 2025, akreditimi i institucioneve të arsimit të formimit profesional u mbështet në Urdhrin e ri të akreditimit me nr. 845 datë 3.7.2025 të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për miratimin e “Rregullores për standardet, kriteret dhe Procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional”.

Bazuar në këtë urdhër, në vitin 2025, në AKAFPK kanë aplikuar për akreditim:

- **5 IoAFP publike dhe 1 IoAFP jopublik**

Procesi i akreditimit është i ndarë në faza:

I. Faza përpara vizitës në terren:

- a) hapi i parë: AKAFPK-ja shqyrton kërkesën për akreditim dhe dokumentacionin shoqërues;
- b) hapi i dytë: AKAFPK-ja merr vendim për vijimin ose jo të procedurës së akreditimit;
- c) hapi i tretë: AKAFPK-ja ngre grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) dhe përgatit vizitën në terren;
- d) hapi i katërt: ofruesi i AFP-së dorëzon dosjen e vetëvlerësimit dhe u përgjigjet pyetësorëve të kërkuar nga GVJ-ja, brenda afateve të përcaktuara.

Verifikimet paraprake janë përqendruar në dokumentacionin fillestar:

Hapi i parë: ofruesi i AFP-së dorëzon kërkesën zyrtare për vlerësim të jashtëm për akreditim, e cila përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) dokumentin që vërteton pagimin e tarifës së aplikimit për akreditim;
- b) dokumentin i hapjes/riorganizimit ose licencës si ofrues jopublik i AFP-së;
- c) përshkrimin e shkurtër të ofruesit për sa i përket objektit dhe historikut të veprimtarisë së institucionit;
- ç) organigramën e institucionit;
- d) rregulloren e brendshme të institucionit;
- dh) dokumentin e pronësisë/qirasë, të vlefshme për kohën e vlefshmërisë së akreditimit;
- e) aktin e brendshëm administrativ për ngritjen e ekipit të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- ë) aktin e brendshëm administrativ për ngritjen e komisionit të shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ose ekipit apo strukturës ekuivalente që kryen funksionet e tij;
- f) raportin e vitit të fundit të vetëvlerësimit për pesë fushat e cilësisë, sipas formatit në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje;
- g) planin afatmesëm, të miratuar për katër vitet e ardhshme, së bashku me parashikimet përkatëse financiare, përfshirë proceset e sigurimit të cilësisë;
- gj) planin vjetor aktual i miratuar, që përfshin proceset e sigurimit të cilësisë;
- h) standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve që vërtetojnë përfshirjen e tyre në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në rastin e ofruesve jopublikë, si dhe dokumentet kurrikulare për kualifikimet profesionale që përfshijnë kurrikulat në nivel shkolle për ofruesit publikë dhe kurrikulat bazë për ofruesit jopublikë, për të cilat kërkon akreditim;
- i) listën e personelit drejtues, mësimdhënës dhe mbështetës, për kualifikimet profesionale, për të cilat aplikon për akreditim, së bashku me kualifikimet dhe përvojën e tyre;
- j) CV-të e personelit drejtues, mësimdhënës dhe mbështetës sipas formatit Europass;
- k) kontratat e punës, të vlefshme për periudhën për të cilën do të akreditohet;
- l) listat e klasave, laboratorëve, mjediseve të praktikës profesionale, pajisjeve, teksteve shkollore, materialeve ndihmëse për mësimdhënien etj., për kualifikimet profesionale për të cilat aplikon për

akreditim;

ll) marrëveshjet kuadër të bashkëpunimit, të nënshkruara me punëdhënësit apo sektorin e biznesit, për realizimin e praktikave profesionale, nëse ka;

m) autorizimet e shëndetit publik dhe certifikatat e sigurisë nga zjarri, të përditësuara, dhe autorizime të tjera që kërkojnë nga legjislacioni në fuqi për ofruesit e AFP-së.

Llojet e akreditimit

1. Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, ministri përgjegjës për AFP në vendos:

a) akreditimin e ofruesit; ose

b) mosakreditimin.

2. Në rast të miratimit të akreditimit, vlefshmëria e akreditimit është 4 vjet, duke filluar nga data e firmosjes së vendimit ose në përputhje me rregullimin e pikës 7 të nenit 20, të Urdhërit nr. 845, datë, 3.7.2025.

Faza e vlerësimit të jashtëm

Pas përmbylljes së fazës së verifikimit paraprak, procesi i sigurimit të cilësisë hyn në fazën e vlerësimit të jashtëm. Kjo fazë përbën një moment kyç në vlerësimin e përputhshmërisë së institucionit me standardet dhe kriteret në fuqi, duke u mbështetur si në analizën e dokumentacionit të dorëzuar, ashtu edhe në verifikimin e drejtpërdrejtë në terren.

Fillimisht, grupet e vlerësimit të jashtëm shqyrtojnë në mënyrë të detajuar dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni aplikues, duke analizuar politikat, procedurat, evidencat dhe të dhënat mbështetëse për secilin standard dhe tregues. Kjo analizë shërben si bazë për identifikimin e çështjeve që kërkojnë sqarime të mëtejshme gjatë vizitës në institucion.

Në vijim, procesi konkretizohet përmes vizitës në terren, e cila zgjat zakonisht 2 ose 3 ditë për çdo IoAFP. Gjatë kësaj periudhe, grupet e vlerësimit zhvillojnë takime me drejtuesit e institucionit, stafin pedagogjik dhe administrativ, nxënësit/kursantët si dhe aktorë të tjerë të përfshirë. Po ashtu, realizohen vëzhgime të drejtpërdrejta të mjediseve mësimore, laboratorëve, praktikave profesionale dhe dokumentacionit shtesë. Të gjitha aktivitetet zhvillohen sipas një agjende të dakordësuar paraprakisht mes palëve dhe të komunikuar zyrtarisht me IoAFP-të, duke garantuar transparencë dhe qartësi në proces.

Në përfundim të vizitës, grupet e vlerësimit të jashtëm diskutojnë dhe dakordësojnë gjykimet përfundimtare për secilin standard dhe për secilën kualifikim profesional të vlerësuar. Mbi këtë bazë hartohet raporti i vlerësimit të jashtëm, i cili i përcillet AKAFPK-së për shqyrtim të mëtejshëm dhe vijim të procedurave përkatëse.

Për proceset ku vizitat në terren janë përmbyllur deri në fund të vitit 2025, është hartuar edhe

raporti përfundimtar i vlerësimit. Ndërkohë, disa grupe vlerësuesish nuk arritën të përfundonin vizitat brenda muajit dhjetor 2025; për këto raste, procesi i vlerësimit dhe hartimi i raporteve përkatëse po vijon gjatë vitit 2026, në përputhje me planifikimin dhe afatet e përcaktuara institucionale.

2.3 AKTIVITETI FINANCIAR

Procesi i akreditimit të ofruesve të AFP-së mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

1. Vendim nr. 673, datë 16.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve” (lidhja 1 dhe 2)
2. Urdhri nr. 845, datë 3.7.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional” i MEKI.
3. Urdhri i brendshëm i AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.7.2025 me nr. 262 prot., “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm, në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”.

AKAFPK i realizon veprimtaritë e saj nëpërmjet financimeve nga buxheti i shtetit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër. Këto financime përdoren për pagesat e vlerësuesve të jashtëm, të cilët janë të kontraktuar nga AKAFPK, si dhe për të mbuluar nevojat materiale për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

Në këtë kapitull janë trajtuar kostot financiare për proceset e akreditimit dhe të monitorimit të ofruesve të AFP-së, për vitin 2025.

Duhet theksuar se për procesin e akreditimit të vitit 2025, shpenzimet do të kryhen në vitin 2026, për arsye se këto procese janë ende të papërfunduara. Si rrjedhim në këtë tabelë gjenden kostot e parashikuara, të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2026.

Gjatë vitit 2025 u parashikuan pagesat sipas kuadrit ligjor të sipërcituar për ofruesit ende në proces akreditimi:

PROCESI I AKREDITIMIT PËR VITIN 2025/KOSTO TË PARASHIKUARA						
Nr	Ofruesit	Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm	Numri i kualifikimeve profesionale	Orët total	Pagesa orë pune/lekë	Totali/lekë
1	Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", Peshkopi	3 anëtarë	16	352	1050	369.600
2	Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastër	3 anëtarë	14	352	1050	369.600
	Shkolla e Mesme	3 anëtarë	28	352	1050	369.600

3	Profesionale "Kamëz"					
4	Shkolla e Mesme Profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë	3 anëtarë	13	350	1050	367.500
5	Shkolla e Mesme Profesionale "Kristo Isak" Berat	3 anëtarë	9	315	1050	330.750
6	Ofruesi jopublik i AFP-së "Albacademy" Tiranë	3 anëtarë	1	192	1050	201.600

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna për shpenzimet në mbështetje të procesit të monitorimit të posaçëm të zhvilluara gjatë vitit 2025.

MONITORIMI I POSAÇËM PËR VITIN 2025				
Nr	Ofruesit	Orët total	Pagesa orë pune/lekë	Totali/lekë
1	Shkolla e Mesme Profesionale "Petro Sota", Fier	52.8	1050	55.440
2	Shkolla e Mesme Profesionale "Stililano Bandilli", Berat	52.8	1050	55.440

Më poshtë jepet lista e plotë e kualifikimeve profesionale për të cilat ka aplikuar secili prej ofruesve të AFP-së për procesin e akreditimit:

Lista e kualifikimeve profesionale të ofruara nga Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", Peshkopi

1. Ekonomi-Biznes, Niveli II i KSHK-së
2. Tregti, Niveli IV i KSHK-së
3. Shërbime Social-Shëndetsore, Niveli II i KSHK-së
4. Shërbime kujdesi për të moshuar, Niveli III i KSHK-së
5. Shërbime kujdesi për fëmijë, Niveli III i KSHK-së
6. Shërbime Social-Shëndetsore, Niveli IV i KSHK-së
7. Teknologji Informacioni dhe komunikimi, Niveli II i KSHK-së
8. Rrjete të dhënash, Niveli IV i KSHK-së
9. Zhvillim Website, Niveli IV i KSHK-së
10. Hoteleri-Turizëm, Niveli II i KSHK-së
11. Kuzhinë, Niveli III i KSHK-së
12. Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së
13. Gjeologji Miniera, Niveli II i KSHK-së

14. Miniera, Niveli III i KSHK-së
15. Gjeologji Miniera, Niveli IV i KSHK-së
16. Teknologji Ushqimore, Niveli II i KSHK-së

Vizita në terren:

Dita 1: 04.11.2025

Dita 2: 04.12.2025

Dita 3: Nuk ishte zhvilluar deri në fund të dhjetorit 2025.

Lista e kualifikimeve profesionale të ofruara nga Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz

1. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Niveli II i KSHK-së
2. Multimedia, Niveli IV i KSHK-së
3. Rrjete të dhënash, Niveli IV i KSHK-së
4. Zhvillim Website, Niveli IV i KSHK-së
5. Shërbime mjetesh transporti, Niveli II i KSHK-së
6. Shërbime elektro-auto, Niveli III i KSHK-së
7. Shërbime motorike, Niveli III i KSHK-së
8. Shërbime elektro-auto (Duale), Niveli III i KSHK-së
9. Shërbime mjetesh transporti, Niveli IV i KSHK-së
10. Hoteleri-Turizëm, Niveli II i KSHK-së
11. Kuzhinë (Duale), Niveli III i KSHK-së
12. Kuzhinë Pasticëri, Niveli III i KSHK-së
13. Shërbime në hotel dhe restorant, Niveli III i KSHK-së
14. Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së
15. Bujqësi, Niveli II i KSHK-së
16. Agroturizëm, Niveli IV i KSHK-së
17. Bujqësi, Niveli IV i KSHK-së
18. Agrobiznes, Niveli IV i KSHK-së
19. Elektroteknikë, Niveli II i KSHK-së
20. Teknologji automatizimi, Niveli III i KSHK-së
21. Elektroteknikë, Niveli IV i KSHK-së
22. Shërbime Sociale dhe Shëndetsore, Niveli II i KSHK-së
23. Shërbime kujdesi për fëmijë, Niveli III i KSHK-së
24. Shërbime kujdesi për të moshuar, Niveli III i KSHK-së
25. Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, Niveli IV i KSHK-së
26. Rrjete të dhënash (Pilot Giz), Niveli IV i KSHK-së
27. Shërbime kujdesi për të moshuar (Pilot Giz), Niveli IV i KSHK-së
28. Menaxhim i strukturave akomoduese (Duale), Niveli V i KSHK-së

Vizita në terren:

Dita 1: 06.11.2025

Dita 2: 05.12.2025

Dita 3: 30.01.2026

Lista e kualifikimeve profesionale të ofruara nga Shkolla e Mesme Profesionale

“Thoma Papapano” Gjirokastrë

1. Shërbime mjetesesh transporti, Niveli II i KSHK-së
2. Shërbime elektroauto, Niveli III i KSHK-së
3. Shërbime mjetesesh transporti, Niveli IV i KSHK-së
4. Elektroteknikë, Niveli II i KSHK-së
5. Instalime elektrike, civile dhe industriale, Niveli III i KSHK-së
6. Elektroteknikë, Niveli IV i KSHK-së
7. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Niveli II i KSHK-së
8. Mbështetje e përdoruesve të TIK, Niveli IV i KSHK-së
9. Termohidraulikë, Niveli II i KSHK-së
10. Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse, Niveli III i KSHK-së
11. Termohidraulikë, Niveli IV i KSHK-së
12. Hoteleri-Turizëm, Niveli II i KSHK-së
13. Shërbime në hotel dhe restorant, Niveli III i KSHK-së
14. Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së

Vizita në terren:

Dita 1: 03.11.2025

Dita 2: 03.12.2025

Dita 3: mbyllur me 2 ditë

Lista e kualifikimeve profesionale të ofruara nga Shkolla e Mesme Profesionale

“Hoteleri-Turizëm”, Tiranë

1. Teknologji Ushqimore, Niveli II i KSHK-së
2. Teknologji e Përpunimit të Brumrave, Niveli III i KSHK-së
3. Teknologji Ushqimore, Niveli IV i KSHK-së
4. Hoteleri-Turizëm, Niveli II i KSHK-së
5. Bar-Restorant, Niveli III i KSHK-së
6. Kuzhinë-Pastricëri (Pilot), Niveli III i KSHK-së
7. Reception (Duale), Niveli III i KSHK-së
8. Shërbime në Hotel dhe Restorant, Niveli III i KSHK-së
9. Kuzhinë (Duale), Niveli III i KSHK-së
10. Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së
11. Kuzhinë VET-by-EHL, Niveli III i KSHK-së
12. Hoteleri VET-by-EHL, Niveli III i KSHK-së

13. Shërbime Ushqimi dhe Pije VET-by-EHL, Niveli III i KSHK-së

Vizita në terren:

Dita 1: 23.10.2025

Dita 2: 14.11.2025

Dita 3: 5.12.2025

Lista e kualifikimeve profesionale të ofruara nga Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat

1. Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, Niveli II i KSHK-së
2. Shërbime Kujdesi për Fëmijë, Niveli III i KSHK-së
3. Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, Niveli IV i KSHK-së
4. Hoteleri-Turizëm, Niveli II i KSHK-së
5. Shërbime në Hotel dhe Restorant, Niveli III i KSHK-së
6. Kuzhinë-Pastiçeri, Niveli III i KSHK-së
7. Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së
8. Ekonomi-Biznes, Niveli II i KSHK-së
9. Tregti, Niveli IV i KSHK-së

Vizita në terren:

Dita 1: 5.11.2025

Dita 2: 17.12.2025

Dita 3: Nuk ishte zhvilluar deri në fund të dhjetorit 2025.

Ofruesi jopublik i AFP-së “ALBACADEMY” Tiranë, i cili ka aplikuar për akreditimin e tre njësive të të nxënës, pjesë e kualifikimit profesional të mëposhtëm:

1. Menaxhim i strukturave akomoduese, Niveli V i KSHK-së

Njësitet e të nxënës:

- Planifikimi dhe organizimi i punës në strukturat akomoduese
- Shitje dhe marketing
- Komunikimi dhe etika profesionale

2.4 MONITORIMI I IOAFP-VE TË AKREDITUARA

Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së, zhvilloi një model të konceptimit të Planit të monitorimit për secilin tip monitorimi dhe metodologjinë përkatëse të zbatimit të tij.

Në këtë kuadër hartuam planin e monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së, duke përfshirë llojet, format dhe instrumentet e monitorimit, i cili u miratua me shkresë nr. 7294/2 prot, datë

27.08.2024, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Pasi u miratua nga MEKI dhe u publikua në faqen zyrtare të AKAFPK-së, së bashku me monitorimin e përgjithshëm, filloi edhe procedura e monitorimit të posaçëm për ata ofrues të AFP-së të cilëve iu dha statusi i akreditimit me kusht.

Monitorimi i posaçëm

Gjatë vitit 2025 u zbatuan dy procese të monitorimit të posaçëm për dy ofrues publikë të AFP-së, të cilët kishin marrë akreditimin me kusht nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Këta ofrues u monitoruan për të verifikuar ecurinë e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm në raportin e akreditimit. AKAFPK-ja pasi zhvilloi të gjithë procedurën e Monitorimit të Posaçëm, në Ofruesit publik të AFP-së, arriti në përfundimin që të propozojë dhënien e akreditimit të plotë për këta dy ofrues si më poshtë;

- 1) Shkolla e Mesme Profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat ⇒ 15 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
- 2) Shkolla e Mesme Industriale “Petro Sota” Fier ⇒ 17 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.

Monitorim individual

AKAFPK, gjatë muajit Janar 2025, vijoi me zbatimin e procesit të monitorimit individual në ofruesit e akredituar të AFP-së duke mbledhur dhe analizuar informacionin e dorëzuar (dërgimi i informacioneve vazhdoi edhe përgjatë muajit Janar 2025) lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna si detyrë nga procesi i akreditimit, si dhe informacione të tjera, të cilat lidhen me funksionimin e ofruesve të AFP-së. Procedura e monitorimit u bazua në përpunimin e të dhënave të mbledhura individualisht nga secili prej ofruesve të AFP-së, (5 ofrues publikë dhe 1 ofrues jopublik).

Ky monitorim u mbështet në:

- Zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të akreditimit shoqëruar me evidencat përkatëse;
- Listën e personelit drejtues, mësimdhënës dhe mbështetës, (nëse ka ndryshime)
- Ndikimin e statusit ligjor “Institucion i akredituar” në regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të. (për të gjitha kualifikimet profesionale, për vitin shkollor 2022-2023; 2023-2024 dhe 2024-2025),
- Zhvillimet më të fundit mbi trajnimet e kryera dhe ato të planifikuara për të gjithë stafin,
- Kualifikimet e reja shtesë të ofertës arsimore për vitet shkollore 2024-2025, përtej listës së kualifikimeve profesionale për të cilat janë akredituar, (nëse ka)
- Infrastrukturën fizike (Listën e klasave, laboratorëve, mjediseve të praktikës profesionale, pajisjeve, cilësinë e mjedisit fizik)
- Autorizimet e shëndetit publik dhe certifikatat e sigurisë nga zjarri (për ambiente shtesë pas procesit të akreditimit)

Pas analizimit të të dhënave të mbledhura deri në janar 2025 nga secili ofrues, u arritën këto

rezultate:

- Ofruesit sollën evidenca për secilin prej rekomandimeve
- Të gjithë ofruesit kanë dërguar listën e personelit të përditësuar
- Të gjithë ofruesit kanë sjellë evidenca për numrin e nxënësve para dhe pas marrjes së statusit “i akredituar”, përveç ofruesit jopublik i cili nuk ka klasë të X-të.
- Të gjithë ofruesit kanë dërguar evidenca lidhur me trajnimet e kryera.
- Të gjithë ofruesit kanë sjellë informacione/evidenca në rastin e hapjeve të kualifikimeve të reja.
- Të gjithë ofruesit i kanë sjellë informacionin e kërkuar (përveç Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, e cila nuk ka sjellë dokumentacionet pas optimizimit për godinën e shtuar).

Monitorimi i përgjithshëm

Në vijim të procesit të monitorimit për vitin 2025, Sektori i Akreditimit, mbështetur në planin e ri të hartuar sipas Urdhrit nr. 845, datë 03.07.2025, njoftoi ofruesit e AFP-së për nisjen e fazës pasuese. Ofruesve iu kërkuar të dorëzojnë të dhëna të përgjithshme mbi veprimtarinë e tyre, si dhe informacion specifik mbi shkallën e zbatimit të secilit rekomandim të lënë nga Grupet e Vlerësimit të Jashtëm në raportet përkatëse të akreditimit për ofruesit e akredituar së fundi. Plani i monitorimit për vitin 2025 përfshiu 9 ofrues të akredituar të AFP-së.

Plani i monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së-2025

Nr	Emri i ofruesit të AFP-së	Data e vendimit të akreditimit	Lloji i akreditimit	Lloji i monitorimit	Forma e monitorimit	Periodha e monitorimit	Njësia përgjegjëse
1	Qendra multifunkionale "New Generation", Tiranë	17 Shkurt 2023	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
2	Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës	6 Tetor 2023 23 Janar 2025 Për kualifikime shtesë	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm Monitorim i posaçëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
3	Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike, Tiranë	6 Tetor 2023	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
4	Shkolla e Mesme Teknike Elektrike "Gjergj Canco", Tiranë	6 Tetor 2023	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
5	Shkolla e Mesme Profesionale "Beqir Çela", Durrës	6 Tetor 2023 21 Maj 2024 Për kualifikime shtesë	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së

6	Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz	6 Tetor 2023	Akreditim i plotë	Në proces akreditimi referuar kërkesës Nr. 274 Prot datë 30.07.2025	-	-	Spektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
7	Shkolla e Mesme Profesionale "Kolin Gjoka", Lezhë	13 Nëntor 2024	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm Monitorim i posaçëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Spektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
8	Shkolla e Mesme Profesionale "Charles Telford Erickson", Golem-Kavajë	23 Janar 2025	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm Monitorim i posaçëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Spektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
9	Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli", Berat	19 Shtator 2025	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm Monitorim i posaçëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Spektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së
10	Shkolla e Mesme Profesionale "Petro Sota", Fier	19 Shtator 2025	Akreditim i plotë	Monitorim i përgjithshëm Monitorim i posaçëm	Në terren dhe/ose në distancë	Dhjetor 2025	Spektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së

Në funksion të garantimit të ecurisë së rregullt dhe mbarëvajtjes së procesit të monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së, sektori i akreditimit e përqendroi punën e tij në ngritjen e një **databaze elektronike** të dedikuar e cila menaxhohet nëpërmjet sharepoint brenda sektorit të akreditimit të ofruesve të AFP-së. Kjo databazë synon administrimin dhe mirëmbajtjen sistematike të të dhënave të mbledhura gjatë monitorimit, duke mundësuar ruajtje të sigurt, identifikim të shpejtë dhe analizë krahasuese të informacionit në periudha të ndryshme përgjatë vitit. Në këtë mënyrë, është forcuar gjurmueshmëria e të dhënave dhe është rritur efikasiteti në ndjekjen e përmbushjes së standardeve nga ana e ofruesve.

Ofruesit u monitoruan për:

- Zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të akreditimit shoqëruar me evidencat përkatëse;
- Listën e personelit drejtues, mësimdhënës dhe mbështetës, (nëse ka ndryshime)
- Ndikimin e statusit ligjor "Institucion i akredituar" në regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të. (për të gjitha kualifikimet profesionale, për vitin shkollor 2025-2026),
- Zhvillimet më të fundit mbi trajnimet e kryera dhe ato të planifikuara për të gjithë stafin,
- Kualifikimet e reja shtesë të ofertës arsimore për vitin shkollor 2025-2026, përtej listës së kualifikimeve profesionale për të cilat janë akredituar, (nëse ka)
- Infrastrukturën fizike (Listën e klasave, laboratorëve, mjediseve të praktikës profesionale, pajisjeve, cilësinë e mjedisit fizik)
- Autorizimet e shëndetit publik dhe certifikatat e sigurisë nga zjarri (për ambiente shtesë pas procesit të akreditimit)

Nga verifikimet e kryera u konstatua se:

- ofruesit duhet të dërgonin evidenca shtesë

- mjetet e raportimit për ofruesit duhet të standardizohen
- disa nga rekomandimet e monitoruara mbeten objekt monitorimi për vitin e ardhshëm
- ofruesit nuk kanë respektuar raportimin në mënyrë periodike pranë AKAFPK-së për çdo ndryshim i cili mund të prekë statusin e akreditimit.

Nga analiza e të dhënave të raportuara rezulton se 6 nga 9 ofruesit e akredituar kanë zgjeruar ofertën e tyre arsimore për vitin shkollor 2024–2025, duke përfshirë kualifikime të reja përtej kualifikimeve profesionale për të cilat janë pajisur me certifikatën e akreditimit. Në total, janë shtuar 14 kualifikime të reja në ofertën arsimore të këtyre ofruesve.

Nga këto, 13 kualifikime rezultojnë të jenë brenda fushës së kualifikimeve profesionale për të cilat institucionet përkatëse janë tashmë të akredituara. Për këto raste, AKAFPK do të vijojë me shqyrtimin e dokumentacionit përkatës vërtetues, me qëllim përditësimin dhe rifreskimin e të dhënave në certifikatën e akreditimit, sipas procedurave në fuqi.

Ndërkohë, është evidentuar edhe shtimi i një kualifikimi të ri jashtë fushës së kualifikimeve profesionale për të cilat ka marrë akreditim ofruesi. Ky ndryshim përbën zgjerim të veprimtarisë përtej kuadrit të miratuar dhe, për rrjedhojë, e detyron institucionin në fjalë t'i nënshtrohet procesit të plotë të akreditimit për këtë kualifikim të ri profesional, në përputhje me përcaktimet e nenit 8 të Urdhrit nr. 845, datë 03.07.2025.

KAPITULLI III: SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE

3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE

AKAFPK, në zbatim të mandatit dhe përgjegjësi të saj funksionale, ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e proceseve përmes mbledhjes, përpunimit dhe arkivimit sistematik të të dhënave. Duke u mbështetur në përvojën e akumuluar ndër vite, sistemi i menaxhimit të të dhënave është strukturuar për të garantuar gjurmueshmëri, saktësi dhe aksesueshmëri të informacionit, duke u fokusuar në këto drejtime kryesore:


- Administrimin e procedurave të akreditimit institucional për kualifikime profesionale sipas niveleve të KSHK-së, përfshirë proceset e njohjes së të nxënit të mëparshëm (joformal dhe informal) si dhe të nxënit gjatë gjithë jetës;
- Monitorimin e vazhdueshëm të ofruesve të akredituar të AFP-së;
- Menaxhimin e komunikimeve elektronike dhe postare në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë;
- Bashkërendimin dhe komunikimin me institucionet partnere, ekspertët dhe vlerësuesit e jashtëm;

- Administrimin e procesit të plotësimit të pyetësorëve, përpunimin e të dhënave dhe publikimin e raporteve përkatëse të rezultateve të procesit të akreditimit.

Statistika mbi dokumentat e arkivës

E gjithë korrespondenca zyrtare ndërmjet AKAFPK-së dhe ofruesve të AFP-së, si dhe me institucione të tjera bashkëpunuese, administrohet dhe arkivohet nga zyra e arkivë-protokollit të institucionit, në përputhje me rregullat për menaxhimin e dokumentacionit zyrtar.

Në grafikun përkatës paraqitet shpërndarja e dokumenteve sipas kategorive dhe llojit të tyre, në lidhje me procesin e akreditimit të ofruesve të AFP-së, duke ofruar një pasqyrë të volumit dhe natyrës së dokumentacionit të trajtuar gjatë periudhës raportuese.



3.2 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

AKAFPK, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut, ndër vite ka ndërtuar një sistem të konsoliduar për dhënien e informacionit dhe informimin e publikut bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit.

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, AKAFPK ka miratuar programin e transparencës dhe e ka publikuar në faqen zyrtare. Ky program, synon të bëjë transparente veprimtarinë e punës së AKAFPK, nëpërmjet pasqyrimit në faqen zyrtare. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare. Në këtë program transparence, AKAFPK ka paraqitur gjithashtu mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit, si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik.

Gjatë vitit 2025, kanë ardhur gjithsej 6 kërkesa për informacion në formë elektronike në e-mailin zyrtar të AKAFPK-së, info.akafp@akafp.gov.al nga subjekte të ndryshme ose individë të interesuar në lidhje me procesin e akreditimit, të cilat janë trajtuar sipas afateve ligjore të dhënies së informacionit.

Në kuadër të transparencës dhe informimit në kohë reale, faqja zyrtare e AKAFPK mundëson informacion për publikun dhe palët e interesuara në format të kuptueshëm dhe të qartë. Faqja e AKAFPK publikon të dhënat në kohë reale duke garantuar për publikun dhe palët e interesuara informacion të përditësuar dhe të besueshëm. *Edhe gjatë vitit 2025, në faqen zyrtare të AKAFPK janë pasqyruar aktivitetet e saj si dhe vendimet për akreditimin e kualifikimeve profesionale të ofruesve të AFP-së.*

Në mënyrë të përmbledhur, disa nga informacionet e të dhënat që i vihen në dispozicion publikut dhe palëve të interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të AKAFPK janë:

- Informacione për procesin e akreditimit me të dhëna për çdo proces të zhvilluar nga çdo ofrues AFP-je, publik dhe jopublik;
- Raporte të akreditimit institucional të ofruesve të AFP-së për kualifikime profesionale sipas niveleve të KSHK-së, njohjen e të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës.
- Vendime të Ministrisë përgjegjëse për AFP-në;
- Publikime të akteve/bazës ligjore mbi të cilat bazohet procesi i akreditimit;
- Raporte vjetore, rregullore, udhëzues, materiale ndihmëse.

3.3 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE

Menaxhimi dhe administrimi i informacionit/dokumentacionit në AKAFPK realizohet përmes një sistemi të strukturuar, i cili zbatohet nga zyra e arkivë-protokollit të institucionit. Çdo dokument trajtohet dhe ruhet si në format fizik, ashtu edhe në atë elektronik, duke garantuar siguri, integritet dhe gjurmueshmëri të të dhënave në arkivë dhe në databazën përkatëse institucionale.

Procesi i ruajtjes dhe arkivimit zhvillohet në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, si dhe me aktet nënligjore për administrimin e informacionit zyrtar. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, AKAFPK klasifikon dokumentacionin sipas statusit të tij (publik, për përdorim të brendshëm ose konfidencial), duke përcaktuar edhe nivelet përkatëse të aksesit. Qasja në dokumentacion për stafin e AKAFPK-së dhe për Vlerësuesit e Jashtëm mundësohet në përputhje me funksionin dhe procesin përkatës, sipas përcaktimeve të rregullores së brendshme.

Në kuadër të proceseve të akreditimit dhe monitorimit, krahas dosjes në version të printuar, në

AKAFPK dorëzohen edhe dokumentet në format elektronik (kur është e aplikueshme), me qëllim lehtësimin e administrimit dhe ruajtjes afatgjatë. Të gjitha evidencat e procesit të akreditimit — si ato të paraqitura nga ofruesit e AFP-së, ashtu edhe dokumentacioni i hartuar nga vlerësuesit e jashtëm — pas përfundimit të procesit përcillen nga Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, konkretisht në zyrën e arkivë-protokollit të AKAFPK-së. Dorëzimi formalizohet përmes një procesverbali zyrtar ndërmjet palëve, duke garantuar saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të arkivuar.

KAPITULLI IV: VEPRIMTARI NË KUADËR TË BASHKËPUNIMEVE

Veprimtari në kuadër të bashkëpunimit me MEI:

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit është dhënë kontribut për;
- Rishikimi i urdhrit ekzistues nr. 128 datë 6.7.2021 “Për miratimin e “Rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.
- Rishikimi i udhëzimit nr. 16 datë 8.5.2018, "Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”.

Veprimtari në kuadër të bashkëpunimit me EQAVET:

- Më datë 26.2.2025 u zhvillua Takimi Kombëtar në lidhje me prezantimin e rezultateve të projektit EQET SEE dhe shfrytëzimi i ngjarjes për rrjetëzim, diskutime dhe iniciativa kombëtare duke bashkuar AFP-në, biznesin dhe ekspertët e sigurimit të cilësisë.
- Më datë dhe 5 nëntor 2025 u realizua Takim dy ditor EQAVET Peer Learning Activity: “The role of quality assurance in advancing basic skills in VET”.

Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së gjithashtu ka bashkëpunuar edhe me Kultur Kontakt (OeAD) si dhe ERISSEE.

Veprimtari në kuadër të përgatitjes së termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm;

- Ndjekja e procedurave për njoftimet për bashkëpunëtorë, për ngritjen e grupeve të vlerësuesve të jashtëm, në kuadër të procesit të akreditimit të IoAFP-ve.
- Përgatitja e kontratave të shërbimit, për bashkëpunëtorët e Sektorit të akreditimit të ofruesve të IoAFP-ve që shpallen fitues.
- Përgatitja e urdhër-pagesave dhe ndjekja e procedurave për pagesën e bashkëpunëtorëve.

- Informimi i grupeve të interesit nëpërmjet rrjeteve dhe mediave sociale për veprimtaritë dhe aktivitetet e sektorit të akreditimit.

KAPITULLI V: PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2026

Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së në AKAFPK ushtron një rol kyç në garantimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri. Në përmbushje të mandatit të tij, ky sektor ka këto funksione kryesore:

- Vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e ofruesve të AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2–5 të KSHK-së, si dhe akreditimin e qendrave të vlerësimit për zbatimin e procedurave të njohjes së të nxënit të mëparshëm (joformal dhe informal) dhe të nxënit gjatë gjithë jetës;
- Ofrimin e mbështetjes metodologjike për proceset e sigurimit të cilësisë për Njësitë e Zhvillimit pranë ofruesve të AFP-së;
- Asistimin e ofruesve në ndërtimin dhe forcimin e sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë, në përputhje me kriteret dhe standardet e matricës së vetëvlerësimit dhe akreditimit;
- Hartimin dhe rishikimin periodik të standardeve dhe kriterëve të akreditimit për qendrat që zbatojnë procedurat e njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal.

Në funksion të këtyre objektivave, për vitin 2026 AKAFPK parashikon realizimin e këtyre aktiviteteve:

- Vlerësimin e cilësisë përmes procesit të akreditimit të ofruesve të AFP-së që paraqesin kërkesë për aplikim;
- Mbështetjen dhe koordinimin e veprimtarisë së Vlerësuesve të Jashtëm, me synim garantimin e mbarëvajtjes dhe integritetit të procesit të akreditimit;
- Planifikimin dhe zhvillimin e trajnimeve për vlerësues të rinj, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të vlerësuesve të jashtëm të certifikuar;
- Përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe administrative për realizimin efektiv të proceseve të akreditimit;
- Monitorimin e vazhdueshëm të ofruesve të akredituar të AFP-së, në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të standardeve të cilësisë;
- Zhvillimin e aktiviteteve bashkëpunuese me aktorë të tjerë në fushën e arsimit dhe formimit profesional për proceset e sigurimit të cilësisë;
- Pjesëmarrjen aktive si partner në projekte ndërkombëtare dhe evropiane ku AKAFPK është anëtare, me synim shkëmbimin e praktikave të mira dhe harmonizimin me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë.